

VENDIM
Nr.867, datë 6.12.2011

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KAMËZ, TIRANË, TË PRONËS NR.198, ME EMËRTIM “QZE (PRT) E REPARTIT USHTARAK NR.3030”, ME VENDNDODHJE NË FRUTIKULTURË KAMËZ, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te bashkia Kamëz, Tiranë, të pronës nr.198, me emërtim “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, me vendndodhje në Frutikulturë Kamëz, Tiranë, për ta përdorur për kryerjen e investimeve publike për ngritjen e një qendre shëndetësore dhe për ndërtimin e një shkolle të re.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr.198, “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, në Frutikulturë Kamëz, Tiranë.

3. Bashkisë Kamëz, Tiranë, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr.198, me emërtim “QZE (PRT) e repartit ushtarak nr.3030”, në Frutikulturë, Kamëz, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, kryetari i bashkisë Kamëz, Tiranë, dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha